

MARRËVESHJE
NË MES TË QEVERISË SE
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
QEVERISË SË MALTËS
MBI BASHKËPUNIMIN KULTUROR

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS dhe **QEVERIA E MALTËS** tutje të referuara si "Palët Kontraktuese",

Duke synuar që të qojnë më tej zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndërkulturore në mes të Palëve Kontraktuese në fushën e kulturës;

Të motivuar nga dëshira të përbashkët, në promovimin e identitetit kulturor e historik si dhe vlerave të përbashkëta në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Palët Kontraktuese janë pajtuar si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes është të zhvillojë dhe mbështesë bashkëpunimin kulturor në mes të dy vendeve në përpjekje për të ndërtuar dhe nxitur marrëdhënie të mira dhe për të lehtësuar dialogun rajonal dhe dialogun Evropian mbi integrimin.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të rrisin bashkëpunimin në mes të institucioneve përkatëse kulturore, shoqatave dhe individëve, dhe do të ofrojnë ndihmën e tyre në menaxhimin e projekteve të ndryshme kulturore.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të përkushtohen për të mbështetur bashkëpunimin mbi trashëgiminë kulturore, aktivitetet muzeore, galerive, folklorit dhe aktiviteteve që ndërlidhen me këtë segment, teatër, opera, balet dhe Filarmoni.

Neni 4

Palët do të nxisin pjesëmarrjen e grupeve artistike në ngjarjet kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 5

Bashkëpunimi

Palët në këtë Marrëveshje do të mbështesin dhe rrisin bashkëpunimin kulturor përmes:

1. Bashkëpunimit të ngushtë në shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e politikave kulturore në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, UNESCO-s;
2. Realizimit të projekteve të përbashkëta në të gjitha disiplinat e kulturës, duke përfshirë seminare dhe trajnime për aktivitete të ndryshme siç janë trashëgimia kulturore, artet vizuale, teatër, kinematografi, muzikë, biblioteka, etj;
3. Shkëmbimit të informatave, ndihma reciproke teknike dhe materiale në fushën e botimit, literaturës dhe aktivitete tjera artistiko-gjuhësore;
4. Iniciativave bashkëpunuese përmes binjakëzimit të qyteteve dhe të bashkëpunimit mes institucioneve lokale kulturore dhe shoqatave tjera të regjistruara kulturore;
5. Bashkëpunimit në mes të qendrave kinematografike të palëve kontraktuese;
6. Bashkëpunimit mes institucioneve të muzikës qeveritare dhe artit skenik (Filarmonisë, Operës, baletit, teatrit, ansambleve tradicionale të këngëve dhe valleve, etj) dhe shoqatave tjera muzikore;
7. Bashkëpunimit midis teatrove profesionale kombëtare dhe teatrove amatore;
8. Bibliotekave, arkivave, galerive, muzeve, institucioneve kulturore dhe të artit, panairove të librit, dhe promovimit të botimeve.

Neni 6

Prona Intelektuale

Palët do të mbrojnë pronën intelektuale dhe do të zgjedhin çfarëdo pengese që ndërlidhet me legjislacionin në fushën e kulturës dhe artit siç janë ligjet e autorësisë, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, mbrojtjen nga pirateria dhe trafikimi ilegal i vlerave kulturore.

Neni 7

Shoqatat

1. Palët do të mbështesin dhe lehtësojnë bashkëpunimin në mes të shoqatave të regjistruara dhe grupeve kulturore;
2. Shoqatat të referuara në paragrafin 1 të Nenit 6 do të njihen për aktivitetet e tyre ligjore kulturore në nivel kombëtar në disiplinat e tyre respektive kulturore.

Neni 8

Trashigimia Kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore, palët pajtohen që të:

1. Përmirësojnë aktet normative në fushën e prezervimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në të dy vendet duke i ndarë praktikat më të mira të kësaj fushe, bazuar në legjislacionin relevant të dy vendeve, dhe rekomandimeve mbi trashëgiminë kulturore;
2. Nxisin prezervimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë së përbashkët kulturore;
3. Ndërtojnë bashkëpunim të drejtpërdrejtë në mes të institucioneve të palëve dhe agjencioneve të specializuara për promovim, prezervim dhe restaurim të objekteve të me trashëgimi materiale dhe jo-materiale;
4. Promovojnë mbrojtjen dhe respektimin e identitetit dhe diversitetit kulturor;

5. Përfshihen në konzervim, mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe të zhvillojnë më tej:

- a) Restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore;
- b) Zbatimi i projekteve të përbashkëta në restaurimin dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore të rëndësisë kombëtare;
- c) Shkëmbimin e ekspertëve në fushën e trashëgimisë kulturore;
- d) Hartat arkeologjike;
- e) Gërmime arkeologjike dhe ekspedita;
- f) Publikime lidhur me vlerat e trashëgimisë kulturore të të dyja vendeve;
- g) Traditat dhe shprehjet gojore, duke përfshirë gjuhën, si një vektor i trashëgimisë shpirtërore kulturore;
- h) Koleksionet Folkloristike;
- i) Ritet dhe ngjarjet festive;
- j) Zejtaritë tradicionale dhe artin e gatimit;
- k) Inventarizimin e pasurisë kulturore;
- l) Arkivat e filmit në fushën e arkeologjisë dhe trashëgimisë;
- m) Organizimin i panairove apo ngjarje të përbashkëta;
- n) Promovimin e turizmit kulturor;
- o) Shkëmbimin e ekspozitave të veçanta;
- p) Realizimin e ekspozitës së veçantë me interes kombëtar.

Neni 9

Kultura

1. Palët do të vendosin bashkëpunimin institucional në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Maltës;

2. Palët do të nxisin kulturën e përbashkët, për të zhvilluar më tej të gjitha nivelet dhe fushat e bashkëpunimit kulturor të të dyja vendeve, kështu duke kontribuar në identitetin kulturor Evropian;

3. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në:

- Shkëmbimin e informatave që ndërlidhen me Konventat ndërkombëtare e që kanë të bëjnë me çështjet kulturore, teme e kësaj Marrëveshjeje;

- Ofrimin e ndihmës në bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në fushat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe bashkëpunimit ndërmjet muzeve të Maltës dhe muzeve të Republikës së Kosovës;

- Shfaqjet artistike dhe ansamble kulturore, në organizimin e koncerteve, shfaqjeve teatrale dhe shfaqjeve të tjera artistike në nivel kombëtar, rajonal apo vendor;

- Realizimin e ekspozitave të veçanta në kuadër të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të institucioneve kulturore;

- Realizimin e kontakteve të përbashkëta dhe shkëmbimin e informatave në fushën e filmit, fotografisë artistike, teknologjive të reja dhe mediave audio-vizuale dhe multimedias;

- Mbështetjen e kontakteve në fushën e literaturës, mbështetjen e rrjetit të botuesve, si dhe përkthimin e veprave të literaturës dhe literaturës profesionale;

- Nxitjen bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të bibliotekave dhe arkivave,

- Palët Kontraktuese do të pajtohen mbi ekspozitat dhe bienalet të organizuara në të dy vendet.

4. Për të qar më tej zhvillimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave, në kuadër të kornizës së mundësive të veta, palët Kontraktuese pajtohen që të nxisin artistët dhe ekspertet e që të vizitojnë vendet respektive.

Neni 10

Botimi

Palët do të rrisin bashkëpunimin në fushën e botimit përmes:

1. Shkëmbimit dhe kembimeve jo-komerciale të librave, botimeve periodike dhe lloje të tjera të produkteve tipografike;
2. Pjesëmarrjeve të përbashkëta në panaire të librit dhe aktivitete të ndërlidhura që do të organizohen në Shtetet e palëve kontraktuese;
3. Shkëmbimit të ekspozitave me produkte tipografike, kushtet dhe afatet që do të përcaktohen në secilin rast konkret nga pala e interesuar e organizatave të Shtetit;
4. Përkthimit të materialit në gjuhët e palëve në kontratë;
5. Mundësimin të botimit të përbashkët të literaturës së palëve;
6. Lejimit të editimit të gjuhëve të huaja të veprave të zgjedhura të literaturës në gjuhët e palëve në kontratë.

Neni 11

Kinematografia

1. Palët do të nxisin zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale në mes të prodhuesve të filmit, si dhe lehtësimin e realizimit të projekteve për prodhim të përbashkët të filmave.
2. Palët do të ftojnë prodhuesit e filmave dhe institucioneve relevante të filmit të organizojnë festival të filmit në të dy vendet respektive.
3. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në aktivitetet që ndërlidhen me festivalet e filmit, organizuar në pajtueshmëri me rregullat dhe specifikat të festivalit.

Neni 12

Ngjarjet e Veçanta

1. Palët nënshkruese të kësaj Marrveshjeje do të dërgojnë ftesa njëra tjetrës për pjesëmarrje të përbashkët në ngjarje rajonale kulturore të organizuara në vendet e tyre respektive.
2. Palët do të përfshihen në ngjarje tradicionale, muzikë, koncerte, festivale të filmit, shfaqje teatrale, panaire të librit, ekspozita të ndryshme të artit dhe trashëgimisë kulturore, etj.

Neni 13

Programi Vjetor i Shkëmbimit

1. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Palët Kontraktuese do të pajtohen të harmonizojnë orarin e tyre final vjetor të aktiviteteve kulturore, duke lehtësuar kështu një program vjetor kombëtar kulturor dhe artistik të shkëmbimit.
2. Programi, sikurse i vendosur në paragrafin 1, do të bazohet në propozimet e nisura nga institucionet kulturore, shoqatat dhe individët e tjerë të interesuar.
3. Nevojat financiare dhe shpenzimet e nevojshme të të dyja Palëve për programin do të përcaktohen për çdo vit.

Neni 14

Hyrja në Fuqi, Kohëzgjatja, dhe Kushtet e Veçanta

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes së njoftimit të dytë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, me të cilin Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se kërkesat e procesit të tyre të brendshëm kushtetues, të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë përputhur.
2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi derisa një njoftim me shkrim për ndërprerjen është paraqitur nga secila Pale Kontraktuese. Marrëveshja

ndërpritet gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit diplomatik me të cilin Pala tjetër Kontraktuese është e informuar për aktin e paraqitjes.

nënshkruar në

....., në gjuhët Shqipe, Serbe,

..... dhe Angleze, të gjitha tekstet kanë

vlefshmërinë e barabartë. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje

në interpretim, teksti në gjuhën Angleze do ketë përparësi.

Për Qeverinë e

Republikës së Kosovës

Për Qeverinë e

Maltës
